



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIAL E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2021:061177
Datë: 30.05.2024
Numri i dokumentit: 05759042

Kom.Dh.Shk.II.nr.26/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së dytë, gjyqtarja Saranda Bogaj-Sheremeti, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Pro Milk Group, me seli në Prishtinë, rr. “Gazmend Zajmi”, kundër debitorit The North Unicorn L.L.C., me seli në Prishtinë-Fushë Kosovë, e përfaqëson sipas autorizimit Shoqëria e Avokatëve Koci & Vokshi, me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr.810/22 të datës 23.10.2023, me datë 24.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pa themeltë ankesa e kreditorit Pro Milk Group, me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr.810/22 të datës 23.10.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.810/22 të datës 23.10.2023, më pikën I të dispozitivit e ka aprovuar pjesërisht prapësimi e debitorit The North Unicorn L.L.C., me seli në Prishtinë dhe ka anuluar pjesërisht Urdhri Përmbarimor P.nr.58/21 i datës 03.02.2021, i Përmbaruesit Privat Afet Mjeku, për pjesën e detyrimit në shumën prej 13,895.35 € dhe përfundon procedura për këtë pjesë të përmbarimit.

Në pikën II e ka refuzuar pjesërisht prapësimi i debitorit The North Unicorn L.L.C., me seli në Prishtinë ashtu që mbetet në fuqi pjesërisht Urdhri Përmbartimor P.nr.58/21 i datës 03.02.2021, sa i përket shumës prej 3,357.84€, së bashku me kamatën ligjore për këtë pjesë të borxhit dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori Pro Milk Group, me seli në Prishtinë, rr. “Gazmend Zajmi”, pa i përmendur shkaqet ankimore, me të cilën e ka kontestuar në tërësi aktvendimin e Gjykatës Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr.810/22 të datës 23.10.2023, me propozim që të aprovohet si e bazuar ankesa e kreditorit, duke e lënë në fuqi Urdhrin për Përmbartim P.nr.58/21 i datës 03.02.2021 si dhe të anulohet aktvendimi KPPP.nr.810/22 të datës 23.10.2023 i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë dhe të refuzohet prapësimi i debitorit.

Përgjigje në ankesa nuk ka parashtruar debitori.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (LPP), si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Pro Milk Group, me seli në Prishtinë, rr. “Gazmend Zajmi”, me datën 03.02.2021 ka paraqitur propozim për lejimin e përmbartimit, kundër debitorit The North Unicorn L.L.C., me seli në Prishtinë, në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturës për shumën e borxhit prej 17,253.19 €.

Përmbartuesi Privat Afet Mjeku, me seli në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka caktuar urdhrin P.nr.58/21 i datës 03.02.2021, duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturave Nr.6389/20 e datës 06.11.2020, Nr. 5925/20 e datës 15.10.2020, dhe Nr.5423/20 e datës 28.09.2020, duke urdhëruar debitorin t'ia paguaj kreditorit shumën e përgjithshme prej 17,253.19€, në emër të borxhit kryesor me kamatëvonesën ligjore prej 8% ne vit duke filluar nga data e lëshimit të secilës fature veç e veç deri ne debitimin përfundimtar si

dhe shpenzimet e procedurës përbarimore duke përfshirë edhe shpenzimet e avokatit sipas rregullores për Tarifën e Avokatëve, nën kërcënimin të përbarimit të dhunshëm dhe pasojave tjera ligjore, përmbushja e detyrimit të realizohet përmes bllokimit të llogarive bankare të debitorit dhe transferimin e tyre në llogarinë e kreditorit, sekuestrimin e letrave me vlerë, sekuestrimi, vlerësimi shënimi i përbarimit në librin publik të paluajtshmërive, shitjen e sendeve dhe përmbushjen e detyrimit të kreditorit, të bëhet përbarimi në pjesën e pasurisë së debitorit në shoqërinë tregtare, dorëzimi i sendeve të luajtshme dhe kreditori të fitoj të drejtën e pengun në sendet e luajtshme.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar KPPP.nr.810/22 të datës 23.10.2023, më pikën I të dispozitivit e ka aprovuar pjesërisht prapësimi e debitorit The North Unicorn L.L.C., me seli në Prishtinë dhe ka anuluar pjesërisht Urdhri Përbarimor P.nr.58/21 i datës 03.02.2021, i Përbaruesit Privat Afet Mjeku, për pjesën e detyrimit në shumën prej 13,895.35 € dhe përfundon procedura për këtë pjesë të përbarimit. Në pikën II e ka refuzuar pjesërisht prapësimi i debitorit The North Unicorn L.L.C., me seli në Prishtinë ashtu që mbetet në fuqi pjesërisht Urdhri Përbarimor P.nr.58/21 i datës 03.02.2021, sa i përket shumës prej 3,357.84€, së bashku me kamatën ligjore për këtë pjesë të borxhit dhe shpenzimet e procedurës përbarimore.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se në rastin konkret, sipas faturave të lartcekura, rezulton se debitori, ka janë bërë tri pagesa në emër të këtij borxhi, dhe atë me datë 22.01.2022 ka bërë pagesë në vlerë prej 6,000.00 euro, me datë 05.01.2021 ka bërë pagesë në vlerë prej 900.00 euro dhe me datë 11.02.2021 ka bërë pagesë në vlerë prej 890.00, apo në total shumën prej 7,790.00 euro. Në këtë drejtim, meqenëse pagesa e pjesërishtme e borxhit nuk është kontestuese as nga vet kreditori, ndërsa nga koha kur palët janë pajtuar se borxhi ka ngelur në vlerë prej 11,147.84 euro, debitori ka bërë pagesa në shumën prej 7,790.00 euro, rezulton se borxhi i mbetur nga faturat mbi bazën e të cilave është lejuar përbarimi është në vlerë prej 3,357.84 euro. Andaj gjykata duke u bazuar në nenin 71 par.1 nën par. 1.2 të LPP-së, me të cilin përcaktohet se prapësimi mund të bazohet vetëm nëse: *"dokumenti në bazë të cilit është marr vendimi përbarues ose urdhri përbarues është prishur, anuluar, ndryshuar ose shfuqizuar në një mënyrë tjetër, gjegjësisht nëse në ndonjë mënyrë e ka humbur efektin e tij ose është konkluduar se është pa efekt juridik"* vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi

duke aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit për shkak se Urdhri Përmbarimor 58/21 i datës 03.02.2021 në shumën prej 13,895.35 është bërë i pa efekt juridik për shkak të pagesës se borxhit në këtë vlerë nga debitori. Ndërsa vendimin mbi përfundimin e procedurës përmbarimore në këtë pjesë të përmbarimit, Gjykata e mbështeti në nenin 66.4 të LPP-se i cili përcakton se *"Pas përmbushjes së kredisë së kreditorit nxirret vendimi për përfundimin e procedurës përmbarimore"*. Në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi, duke e lënë në fuqi urdhrin e përmbaruesit privat P.nr.58/21 i datës 03.02.2021, në shumën prej 3,357.84 euro, pasi që gjeti se faturat në bazë të se cilave është lejuar urdhri për përmbarim dhe nga të cilat buron borxhi i lartcekur, i plotësonë kushtet për të qenë dokumente të besueshme dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara në përputhje me nenin 29.3 të LPP-së, kjo pasi që në secilën faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara qartë shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturave, është përcaktuar shuma e cila ishte detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi. Pra si faturat si në pikën II, janë dorëzuar origjinal sipas përputhjes me neni 37 të LPP-së dhe janë të pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt, që vërtetohet edhe që nuk është përmbushur borxhi për pjesën të mbetur të detyrimit.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë, e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë, në bazë të nenit 194 të LPK-së, i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarimore me rastin e vendosjes për aprovim të pjesshëm të prapësimin të debitorit. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, Dhomat e Shkallës së Parë drejtë kanë vlerësuar gjendjen faktike kur kanë konstatuar se janë bërë tri pagesa në emër të këtij borxhi, dhe atë me datë 22.01.2022 ka bërë pagesë në vlerë prej 6,000.00 euro, me datë 05.01.2021 ka bërë pagesë në vlerë prej 900.00 euro dhe me datë 11.02.2021 ka bërë pagesë në vlerë prej 890.00, apo në total shumën prej 7,790.00 euro. Në këtë drejtim, meqenëse pagesa e pjesërishtme e borxhit nuk është kontestues as nga vet kreditori, ndërsa nga koha kur palët janë pajtuar se borxhi ka ngelur në vlerë prej 11,147.84 euro, debitori

ka bërë pagesa në shumën prej 7,790.00 euro, rezulton se borxhi i mbetur nga faturat mbi bazën e të cilave është lejuar përmbartimi është në vlerë prej 3,357.84 euro. Andaj gjykata duke u bazuar në nenin 71 par.1 nën par. 1.2 të LPP-së, me të cilin përcaktohet se prapësimi mund të bazohet vetëm nëse: *"dokumenti në bazë të cilit është marr vendimi përmbartues ose urdhri përmbartues është prishur, anuluar, ndryshuar ose shfuqizuar në një mënyrë tjetër, gjegjësisht nëse në ndonjë mënyrë e ka humbur efektin e tij ose është konkluduar se është pa efekt juridik"* vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi duke aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit për shkak se Urdhri Përmbartimor 58/21 i datës 03.02.2021 në shumën prej 13,895.35 është bërë i pa efekt juridik për shkak të pagesës së borxhit në këtë vlerë nga debitori. Ndërsa vendimin mbi përfundimin e procedurës përmbartimore në këtë pjesë të përmbartimit, Gjykata e mbështeti në nenin 66.4 të LPP-se i cili përcakton se *"Pas përmbushjes së kredisë së kreditorit nxirret vendimi për përfundimin e procedurës përmbartimore"*. Gjithashtu sipas vlerësimit të kësaj gjykate, Dhomat e Shkallës së Parë drejtë dhe saktë kanë vlerësuar gjendjen faktike kur kanë konstatuar se në pikën, II të dispozitivit duke e lënë në fuqi urdhrin e përmbartuesit privat P.nr.58/21 i datës 03.02.2021, në shumën prej 3,357.84 euro, pasi që gjeti se faturat në bazë të se cilave është lejuar urdhri për përmbartim dhe nga të cilat buron borxhi i lartcekur, i plotësonë kushtet për të qenë dokumente të besueshme dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara në përputhje me nenin 29.3 të LPP-së, kjo pasi që në secilën faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara qartë shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturave, është përcaktuar shuma e cila ishte detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi. Në këtë drejtim gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar kushtet ligjore nga Neni 29 par. 1 dhe par. 3i LPP, i cili përcakton se *"Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm"*. Ndërsa neni 37 përcakton se *"Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit"*.

Mbi bazën e kësaj dispozite ligjore, kjo Gjykatë vlerëson se dhomat e shkallës së parë kanë konstatuar drejtë se faturat si dokument i besueshëm mbi të cilën ishte iniciuar procedura përmbartimore, respektivisht është lejuar përmbartimi nuk i plotëson kushtet në mënyrë kumulative që duhet t'i ketë dokumenti i besueshëm. Në rastin konkret qartë rezulton se disa faturat nuk e janë, mbi bazën e së cilës mund të konstatohet ekzistimi i detyrimit dhe pranimit si i tillë nga debitori. Së këndejmi, Gjykata thekson se pa plotësimin e këtij kushti dokumenti i

besueshëm nuk mund ta ketë fuqinë e titullit përmbarues sepse rezulton se janë dokumente të pa vërtetuar nga origjinaliteti ose janë kopje dhe dokumentet e besueshme në raport me dokumentet tjera përmbarimore duhet ta kenë fuqinë e pa kontestuar ekzekutive në mënyrë që procedura përmbarimore të iniciohet përmes këtyre dokumenteve. Sa i përket faturave tjera që janë lartëcekura si në pikën II, ato përmbajnë të gjitha tiparet nga dispozitat e LPP-së, pasi që janë prezantuar në origjinal dhe përmbajnë nënshkrimi dhe vulën e debitorit prandaj, i validohen me pranimin e faturave përderisa janë të nënshkruara nga përfaqësuesi i debitorit apo debitori.

Së këndejmi, edhe gjykata e shkallës së dytë është e qëndrimit të njëjtë juridik se në procedurën përmbarimore organi përmbarues, përfshirë këtu edhe gjykatën që ka kompetencë shqyrtimin e ligjshmërisë së përmbarimit, nuk ka tagër të vlerësojë ligjshmërinë e raportit juridik nga i cili rrjedh dokumenti i besueshëm, statusin e palëve apo detyrimet e ndërsjella mes tyre. Por, organi përmbarues, përfshirë edhe gjykatën e shkallës së parë shqyrton vetëm rregullsinë dhe përshtatshmërinë e dokumentit përmbarues dhe/apo atij të besueshëm, me ç'rast procedura sipas prapësimi i nënshtrohet vetëm shqyrtimit formal të titullit ekzekutiv.

Andaj, duke marr parasysh pretendimet ankimore, të cilat konsistojnë ndaj aktvendimit të ankimuar, Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhoma e Shkallës së Dytë konsideron se këto pretendimet ankimore janë të pa bazuara, ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, dhe zbatimin të gabuar të se drejtës materiale, të cilat shkelje kjo gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe as të Ligjit të Procedurës Përmbarimore.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 209 pika b) të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhoma e shkallës së dytë
Kom.Dh.Shk.II.nr.26/24 dt. 30.05.2024

Gjyqtarja,
Saranda Bogaj-Sheremeti.